

DIANA DJALOSHI

**SHPREHJA E MENDËSIVE PËRMES FIGURAVE
RETORIKO-STILISTIKORE DHE FRAZELOGJIZMAVE**

Figurat retoriko- stilistikore¹

Figurat retoriko-stilistikore të përdorura kryesisht në stilin e lartë të gjuhës së shkruar, sidomos në publicistikë, zhanret e letërsisë, në gjuhën e liderave, në medie, parlament, por edhe në të folurin politik etj., pasqyrojnë mendësitë e subjekteve folës në forma më të spikatura, meqë ato i shprehin më qartë ngjyresat kuptimore si informacion të mbishtresuar (dytësor) mbi atë objekt që merr vlera subjektive të ndërtuara nga vetë subjektet. Figurat retoriko-stilistikore të përdorura sidomos në diskursin politik kanë forcë të madhe shprehëse dhe bindëse (perlokutive²). Përdorimi i tyre në ligjërim rrit nivelin e mbështetjes dhe të solidaritetit të publikut me liderat politike si dhe çështjet e ndryshme politike që shtrihen për diskutim. Këtu po paraqesim figurat më kryesore retoriko - stilistikore të pasqyruara në njësitë përkatëse ligjërimore, të nxjerra nga burime të ndryshme nga ligjërimi i shkruar, por edhe nga ai i folur:

Krahasim: Të bërit më të qartë, më të gjallë e mendimit, duke vënë përballë një koncept më të kuptueshëm, por të ngjashëm si p.sh.: “*Qeveri si furgonët e ndërhyrjes së shpejtë³*”; “*Në mbledhje ra një e ftohtë prej akulli⁴*”; “*Ky u gjend ngushtë se nuk e priste pyetjen si thikë⁵*”; “*I hodha disa herë sytë Malenkovit, që ishte bërë si baltë, i verdhë në të hirtë*”; “*Voroshilovi ishte bërë i kuq si paparunë*”; “*Vëllkoja rrinte si një “shkëmb i ngrirë*”; “*Sipas tyre akulli i krijuar si mal në mes nesh e revizionistëve titistë mund të çahet⁶*”, “*Kryeministri jonë sillet me pushtetin e katërt si një Don Zhuan që për zgjedh vetëm femrat që i përulen⁷*”.

Alegori: Njësi me kuptim të dyfishtë, ku kuptimi i dytë fshihet nën të parin dhe zbulohet nga lexuesi, si p.sh.:

- “*Dy luanë që ka bota / një Azia e një Europa*” (në Azi dhe Europë nuk ka luanë, por nënkuptohen ata të cilëve iu vishen këto tipare (dy liderëve Maos dhe Enverit).

- “*Anija që po mbytet⁸*” (anija nënkupton qeverinë).

¹ F. Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, “Infbotues”, Tiranë, 2013.

² Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës, prej Antikitetit deri në kohën e sotme*, “Arbëria”, 2010.

³ I. Yzeiri, *Në vend të hashashit, shkollën*, “Shqip”, Tiranë, 7-9-2015.

⁴ E. Hoxha, *Hrushovianët: Kujtime*, Tiranë, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1980, f. 25.

⁵ E. Hoxha, shih 4, f. 25.

⁶ E. Hoxha, shih 4, f. 36/148/133.

⁷ A. Bushati, *Një përgjigje për Ramën: “Ne do vazhdojmë me Laps në dorë”*, “Lapsi al”, Tiranë, 16-10-2015.

⁸ F. Lubonja, *Rama peng apo pjesë e kimit?*, Panorama, 15-9-2015.

- “Teatri i Kullës së Ngujimit dhe imazhi i shqiptareve sot⁹” (kulla e Ngujimit = Parlamenti).

Shembuj ku njerëz të caktuar, janë cilësuar si kafshë:

- “Erdhi kjo *dhelpra plakë*” (një deputet për një deputet nga partia kundërshtare në moshë disi të madhe).

- “*Kalë i ngordhur politikisht*¹⁰”

Animizëm: Qenia jofrymore perceptohet dhe paraqitet si e gjallë:

- “Rritet *lulja* përmbi gur” – për një vajzë të bukur në një fshat malor me shumë gurë.

- Ja dhe “*trëndafili i PD*” (një qytetar për një politikane të pashme);

Personifikim: Kur një sendi i vishen cilësitë e frymorit: “Në Stadiumin e ri të Shkodrës ndeshjen e kthimit me Serbinë do ta ndjekin njëzet mijë *zemra*” (E. Rama). Partia është nëna jonë e madhe (thënie në monizëm për Partinë). “*Motra e madhe*” (në monizëm për Kinën), “*Vëllai i madh*” (në monizëm për ish BS) etj.

Ironi: Lojtari X: - “Platini donte që ta thyeja karriken me kokën time” (Karrikja që iu thye në kokë lojtarit shqiptar në Beograd nga ana e tifozëve serbe); - “Të dëgjojmë doktorin një herë”, (Një deputet i partisë socialiste në Parlament). - “Ju qan *zemra* për votuesit juve, posi”!, (Një deputet i opozitës për mazhorancën). I. M. dhe J. T. shkëmbejnë ironi me njëri-tjetrin në Parlament: I. M: - “Do zbukurohej për protestë”. J. T.: - “Je kthyer në klloun¹¹”. I. M: - “Shumë vonë është zgjuar kjo zonja, si shpjegohet? Kjo do të vijë edhe me dhunë në pushtet edhe zgjohet në orën 11. Ata të shkretët me 10-leksha janë zgjuar që në 5 të mëngjesit në autobuza”; “J. i kërkon njerëzve të ngrihen në këmbë e të shporin për zhelesh qelbësirat¹²”, “Të fortët e krimit¹³”.

Paralelizëm: Figurë shumë e përdorur për të përçuar mesazhe, sidomos në politikë, ku krahasohen dy objekte, dukuri nëpërmjet të përshkruarit të tyre paralel: “*Balja dhe Bulja* punëtore në tezgjah / dhe të dyja shkojnë krah për krah / Oh sa zjarr që kanë në gji / *Stakanovistet* shpejt me ia mbrri”: (Balja dhe Bulja, punëtore në Shqipëri) = *Stakanovistet* (në BS); “Partia demokratike shkon në *rritje* / Partia socialiste shkon në *rënie*” (sipas politikaneve të djathtë), “*E lindën shpresat dhe po e fundos budallallëku*” (politikanët e majtë për PD); “*Muri i dikurshëm i Berlinit* është zëvendësuar me *murin e padukshëm të diferencës* që ka në themel konfliktin e përhershëm të *Unit* me *Tjetrin*¹⁴”; “*Historia jonë dhe e Ballkanit* në përgjithësi është si një *ndërtim pa leje*¹⁵”; “*Shkolla shqiptare* është *gropa e zezë* më e errët që kemi¹⁶”.

⁹ I. Yzeiri, shih 3.

¹⁰ A. Bushati, *Ata që Prifti nxorri lakuriq*, “Lapsi al”, Tiranë, 1-10-2015.

¹¹ Artikull gazete 12, 03, 2015.

¹² A. Bushati, *Rreziku i një opozite qesharake*, “Lapsi al”, Tiranë, 23-9-2015.

¹³ F. Lubonja, shih 8.

¹⁴ S. Berisha, *Pse demokracia nuk të bën të lumtur*, “Faqja sociale Facebook”, 3-5-2015.

¹⁵ S. Berisha, *Atdheun nuk mund ta duash i vetëm*, “Faqja sociale Facebook”, 1-9-2015.

¹⁶ S. Berisha, shih 14.

Shprehja e mendësive përmes figurave retoriko-stilistikore...

Antitezë: “Partia Demokratike e çoi në rënie, ne po e çojmë në rritje” (E. Rama); “Dëmi i *madh* i një mashtrimi të *vogël*”; Në reklama “Komuniko shumë, shpenzo pak”; “**Midis emfazës vertikale dhe dëshirës horizontale**”¹⁷.

Antonimi: Fjalë me kuptime të kundërta: “Ishim *mirë*, kur ishim *keq*” (të moshuarit për periudhën e monizmit, duke e krahasuar me periudhën e pluralizmit).

Perifrazë: Figurë që ndërtohet duke i quajtur njerëzit, dukuritë apo sendet jo me emrat e tyre reale, por me një njësi apo shprehje duke u dhënë disa karakteristika të veçanta: Për E.H., “*Skënderbeu i kohës tonë*” (në monizëm); Për S.B., “*Ky burrë i madh shteti*” (në pluralizëm); Për kryeministrin grek “*politikani pa kravatë*”¹⁸.

Litota: Figurë e kundërt e me hiperbolën, ku shkurt thuhet me më pak fjalë diçka, me qëllim që të lihet të kuptohet më shumë.

- “*Ai (E.R.) ka bërë zero punë*” (Fjalët e S. Oldashit në fushatën për kandidaturën për postin e kryebashkiakut në Tiranë përballë me E.R.). – “*Kjo është Shqipëria 1Euro*” (PS për PD).

- “*Ky është një personazh i vockël fare*”¹⁹.

Hiperbola: Figurë që shpreh ekzagjerim: Për Partinë (në monizëm) nga B. Londo²⁰ “*S’më mjaftokan, jo, 30 vjet që të jem biri yt / S’më mjaftokan bile as dy jetë*”; F.N. për veten: - “*Unë jam Fatos Nano, prapa më vjen historia*”;

Metaforë: Figurë që i jep një fjale kuptimin e një fjale tjetër. Metaforat shprehen duke identifikuar njerëzit me sendet (kryesisht në monizëm) si p.sh.: *yll i karvanit, uniformat blu, duar të çelikut, armë e ndritur (e socializmit)*:

Shembuj: “*Vallëzojnë vështrimet e personazheve*”²¹; “*Pa anastezinë e censurës e të qepurat e dites*”²². “*Polonia ishte motra e madhe*” e Bashkimit Sovjetik hrushovian. Pastaj vinte Bullgaria, të cilën hrushovianët e kanë kthyer në një “*bijë të bindur*”²³ të tyre”; “*Partia mbulohej nga një ndryshk i rëndë, nga apatia politike, duke menduar gabimisht se vetëm koka, udhëheqja vepron e zgjidh gjithshka*”²⁴. “*Ndërkaq nepërka revizioniste që po gjallërohej nisi të derdhë edhe helmin mbi figurën dhe veprën e Stalinit*”²⁵; “*Prapa tyre ato ditë, pak si më në hije qëndronte një panterë që përgatitej të gëlltiste e të likuidonte dy të parët*”²⁶;

¹⁷ S. Berisha, shih 14.

¹⁸ A. Bushati, *Ndeshja / Pse kaq frikë kundër Serbisë?*, 21-9-2015.

¹⁹ S. Berisha, “*Faqja sociale Facebook*”, Maj, 2015.

²⁰ B. Londo, *Ti je zemra, Parti*.

²¹ E. Rama, *Kurban*, Botimet “Dudaj”, Tiranë, 2011.

²² E. Rama, shih 21.

²³ E. Hoxha, shih 4, f. 144-145.

²⁴ E. Hoxha, shih 4, f. 43.

²⁵ E. Hoxha, shih 4, f. 49.

²⁶ E. Hoxha, shih 4, f. 16.

“Titoja i dërgoi haber të *dashurit të tij të ri*, në prill 1955, se ishte dakord të *vinin kurorë* dhe e ftonte të bënin ‘*dasëm*’²⁷”.

Pyetje retorike: Pyetje që nuk kërkojnë përgjigje ku shembull përbën pyetja retorike me ngjyresë humori: - “*Doni më për Belulin?*”; (Kush do të vjedhë sa më shumë? Kush? Kush?) (PD për PS dhe e kundërta); “*Ku i ke premtimet për mjekësinë falas, shoku Edi?*”; “*E çfarë mund të them më tepër për bëmat, prapaskenat e këtij njeriu*”²⁸; “*Çfarë ka xhanëm partia që e lindën shpresat dhe po e fundos budallallëku*”²⁹; “*Po çfarë po ndodh kështu? Jemi të paaftë për të ndërtuar shtet? Jemi vërtetë kaq fatkëqij sa nuk dimë të zgjedhim? Jemi vërtetë të mallkuar që çdo vit të përsëritim të njëjtin refren*”³⁰?

Replika:

Në Parlament: “*Unë do të thoja të kundërtën: Ju jeni përpjekur për të penguar punën me bojkotin tuaj*” (një deputet i krahut të majtë).

Ramiz Alia dhe Sali Berisha (1989 Takim me intelektualët”):

R.A. –*Por, ajo presupozon të kesh parti të tjera. Domethëne ti je me këtë?*

S.B. - *Për stadin aktual, ky popull nuk është përgatitur.*

R.A. –*Mos e shiko tek çështja e përgatitjes. Sidoqoftë nëse do të pranosh një lojë, duhet të shikosh fundin.*

S.B. –*“Por që të mos jetë e sanksionuar në Kushtetutë unë jam dakord. (Never say never)Kurrë mos thuaj kurrë*”³¹”.

Manierizëm: Përdorimi i tepruar i zburimeve, kur autori kërkon të shkëlqejë me çdo kusht duke përdorur fjalë e shprehje të stërholluara dhe jo të natyrshme, si edhe të huaja. Këtu sillen shumë të tilla, sidomos nga fjalimet e F. Nanos, E. Ramës, S. Ngjelës etj.) si p.sh.: “*Do të jemi në kërkim të zgjedhjes racionale të situatës kritike për të kolauduar një qëndrim koherent jo evaziv*” (F. Nano); “*Tullumbacja e super masave dhe super dënimeve, me etiketime për tradhëti kombëtare duhet shfryrë*”³²”.

Proliksitet: Fraza të stërzgjatura, me lidhje të ndërlikuara sintaksore, por me logjikë të brendshme: “*Ishte për mua një akt i mirëfilltë qytetar, pikërisht sepse shumica dërmuese e tyre sot e gjithë ditën nuk i kanë, por kur më komunikuan përpara publikimit më bënë mua, sepse përjetova fort brenda meje*”³³”.

Pleonazmë: Përdorim i fjalëve të tepërta, sinonime, si jo të domosdoshme, por që shërbejnë për të përforcuar idetë si p.sh.: “*Unë si president i Republikës, si kryetar i shtëpisë, si person që më kanë vënë në krye të parëve*”³⁴”.

²⁷ E. Hoxha, shih 4, 113.

²⁸ E. Rama, në faqen sociale “Facebook”.

²⁹ E. Rama, në faqen sociale “Facebook”.

³⁰ I. Yzeiri, shih 3.

³¹ P. Zogaj, *Fillimet*, Tiranë, 2014, f. 180.

³² A. Bushati, shih 12.

³³ E. Rama, shih 21, f. 192.

³⁴ E. Rama, shih 21, f. 192.

Shprehja e mendësive përmes figurave retoriko-stilistikore...

Pretericion: Kur ai që shkruan apo flet shpall se nuk do të thotë një gjë të tillë, por realisht e shpreh qartë: “Nuk dua të flas për sukseset e qeverisë që janë të mëdha, por për shtrembërimin që po i bën opozita fjalës së lire”. (E. Rama).

Epitet: Fjalë për të cilësuar, karakterizuar, për të vënë në dukje një aspekt të veçantë: “Njeri i ri”, “njeri i vogël”, “ai i gjati”, “i gjati”, “i shkurtri”, “maloku” etj.

Hipotipozë: Përshkrimi i një personi, sendi apo ngjarje me një gjallëri e pasuri gjuhe, sa të na duket sikur e kemi të gjallë parasysht: “Atje, në shkallët e ngushta e zyrat e vogla, hynin, dilnin, bisedonin, debatonin, të persekutuar politikë, të goditur një regjim apo me cene në biografi”.

Ideshmëri: Kërkesa e ideologjisë së realizmit socialist, ku sipas saj, letërsia, kryesisht politike, duhej mbushur me ide (ideologji) politike dhe sociale, ku të realizohej boshti ideologjik edhe atje ku s’ ishte i nevojshëm. Ideologjizmi edhe atje ku ishte i nevojshëm: në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (1980) tek “Parimet teorike të Fjalorit”: “duke u mbështetur në konceptin....”, “Kjo gjuhë e kristalizuuar në epokën e lavdishme të socializmit...”.

Idiomë: Shprehje karakteristike që nuk mund të përkthehet fjalë për fjalë në një gjuhë tjetër dhe që kuptohet në sfondin e një situatë të caktuar apo periudhë të caktuar: “Qeveri e dalë prej hundësh”, “Vaj medet kush e drejton këtë Kuvend! Le ta thotë “vajmedeti” (L. Basha për E. Ramen); “Kjo qeveri “po e ha turpin me bukë”... (Debate në Parlament).

Imitim: Marrje si model i thënieve, personazheve etj., nga veprat e shkrimtarëve të shquar: “Bojkoti i vetmisë së madhe” (imitim nga: Ismail Kadare “Dimri i Vetmisë së Madhe”); “Donkishoti i hapjes së dosjeve”; “Ky është Uriah Hipi i shëmtuar i politikës shqiptare” etj.

Karakter: Figura e njeriut me tipare individuale e shoqërore të theksuara dhe të vizatuara me saktësi. Shpesh janë marrë shumë karaktere nga kinematografia apo letërsia për të karakterizuar personazhe politike: “Plaku Mere” për S. Berishën, “Nënë Pashako”, “Shoqja Ollga” etj.

Klishé: Vargje, përshkrime, situata, të cilat janë të gatshme dhe kanë përsëritshmëri të lartë të fjalëve apo togjeve të fjalëve, sidomos në veprat e realizmit socialist si: *luftë klasash, armiku i klasës* etj. Shumë shprehje klishë përdoren edhe në ditët e sotme si p.sh.: *pjesëmarrja në vendim-marrje, barazia gjinore, kapje e shtetit*³⁵, *integrimi europian, qeversje lokale, politikëbërje, qeveri e duarve të pista* etj.

Humor: Një nga format e komikës që pasqyron anët me humor të sendeve, të dukurive apo të njerëzve. Dialog nga një debat në parlament:

T. Doshi – “Kam një pyetje për nenin 101. Shoku Fatmir tha se duhet të ishte ministri për t’iu përgjigjur”.

F. Xhafaj: “Zoti Doshi, të lutem”. T. Doshi: “Na e kena shoku, se kështu thotë shoku Gramoz”.

³⁵ F. Lubonja, *Rama peng apo pjesë e krimit?*, “Panorama”, Shtator, 2015.

- “*Shoku Sali ka porositur*” ... (thënie në Parlament).

Thënie komike (tallje): Thënie për të shprehur tallje, si p.sh.: “*Qiti jashtë për zhelesh!*” (thënie e J. T. në Parlament, e kthyer si thënie komike me elementet përbërës të njësisë si: “qiti”, “prej zhelesh”).

Kontrast: Vënie përballë e figurave artistike, karaktereve, tablove, ndjenjave, ideve e tipareve të kundërta: “*Ata (armiqtë) na kanë në grykë të pushkës, ne i kemi në grykë të topit*” (Thënie e E. Hoxhës).

Krahinorizëm: Fjalë krahinore, të përdorura jashtë gjuhës standard: “*Kapeni prej zhelesh dhe qiteni jashtë Parlamentit*”; “*Mue më kanë thanë*”; “*Qfarë do të thotë kjo?*”

Lakonizëm: Shprehje e shkurtër dhe e qartë, (karakteristikë për lakonët (spartanet) në Greqinë e lashtë, të cilët flisnin shkurt me aforizma): “*Pjesëmarrja e gruas në vendim marrje, pjesëmarrje e qytetarëve në vendimmarrjen lokale, pjesëmarrja e popullit në qeverisjen e vendit, barazi në vendimmarrje etj.*”

Maksimë: Parim logjik ose moral i shprehur në mënyrë të përmbledhur, si një lloj sentence, por që i jepet vlerë përgjithësuese: “*Populli në këmbë, partia në ballë*”; “*Pushtetin është e lehtë t’a fitosh, por e vështirë ta mbash*”; “*Pushteti del nga gryka e pushkës*”; “*Diktatura e proletariatit është forma më e lartë e demokracisë*” (maksima të përdorura në monizëm).

“*Luftojmë dhunën në familje; Luftojmë dhunën me bazë gjinore*” (maksima të përdorura në pluralizëm).

Mallkim: Një lloj apostrofe e fuqishme, qortim i rëndë që i drejtohet një personi, një institucioni apo një dukurie: “*Ju vraftë Zoti që na vratë djemtë*” (mallkim i një nëne për të vrarët e 21 Janarit).

Oratori: Aftësia e të folurit me art: “Çdo individ i angazhuar në jetën publike duhet të ketë parasysh dy gurë kilometrikë në përditshmërinë e tij, të përkufizuar tash një mijë vjet më parë nga Ibn Sina, Avicena: “ironinë e limiteve dhe kotësinë e stërmundimit³⁶”.

Parafrazë: Thënie me fjalët e tua të asaj që thotë paraardhësi, duke përdorur sinonime apo mënyrë tjetër të të thënit të së njëjtës gjë për ta bërë komunikimin më të kuptueshëm: “Nëse ju kuptova drejt ju po thoshit që ne kemi ardhur këtu për t’u marrëveshur”.

Përsëritje: Figurë retoriko-stilistikore e formuar duke përsëritur disa herë me radhë ose në largësi të vogël të njëjtën frazë: “Ne do të fitojmë, ne do të fitojmë, ne do të fitojmë!” (Lideri i PD në fushatën parazgjedhore); “Do fitojmë apo jo? Po, po, po / Do fitojmë apo jo? Po, po, po!” (Slogan i përdorur në fushatën parazgjedhore).

Retorikë: Dituri që mëson rregullat e oratories, sot me kuptimin kryesor, që u japim rëndësi formës së jashtme, si shprehjes, stilit, tonit etj., për të nxjerrë në pah veten. Filozofi grek Platoni që jetoi në shekullin e tretë p.e.r kishte thënë se: “*një elitë intelektuale dhe me parime etike e filozofëve duhet të ushtrojë pushtetin në*

³⁶ E. Rama, në faqen sociale “Facebook”.

Shprehja e mendësive përmes figurave retoriko-stilistikore...

një vend, gjersa ekspertët duhet të merren me çështje profesionale dhe teknike” (L. Hellspång: Konsten att Tala Arti i të folurit, 2004).

Retorika përdoret shpesh në të folurën e politikanëve, deputetëve, në fjalime, debate etj. Mund të bëhet në parlament në vend të një diskutimi të thjeshtë, ku ka përshkrime të gjata, shpjegime të kota, por me fraza të bukura (ndonjëherë pa ndonjë përmbajtje të caktuar). Këtu mund të sillen shembuj të shumtë nga F. Nano, S. Berisha, E. Rama, B. Topi, S. Ngjela etj., apo edhe nga gazetarë dhe analistë si p.sh.: “Kryeministri që hiqet “adil” (i ndershëm), dhe që të mos flasë lart e poshtë edhe ai ia di “kimenë parasë”. Pastaj numëron institucionet. Gjyqësori, që përfaqësohet nga Sheh Islami, “nuk kaçirdis paranë” (nuk e lë t’i ikë rasti i mirë) edhe ai ia di “kimenë parasë”. Myftiu, myderrizi, kyrra-vizët (përfaqësuesit e administratës shpirtërore, drejtuesi i bashkësisë islame, mësuesi i medresës dhe predikuesi i kuranit), të gjithë këta ia “dinë kimenë parasë”. Po ashtu kadiu, shehu i teqesë, pashallarët, bejlerët, të cilëve po t’u tregosh paranë thotë i ziu Hasan, “ndryshe e vërtisin sherianë”, domethënë ndryshojnë edhe shkrimin e shenjtë³⁷”.

Sarkazëm: Shkalla e shprehjes së ironisë me karakter të hidhur, sulmues, kur shpreh urrejtje dhe përbuzje: “Ne nuk jemi aleatë të NATOS, ne jemi aleatë të ISIS. Po ku jeni o vend kështjellë buzë Adriatikut, o kala e pamposhtur, o fanar ndriçues, o superfuqi energjitike? Po ku jeni o dhjetoristë, o psikanalistë, o opinionistë, o ithtarë të demokracisë? Po ku jeni o pjesëtarë të vendit nga erdhi nënë Tereza, o qytetarë të vendit me tolerancë fetare më të madhe në botë, të vendit më mikpritës në botë? Po ku jeni o banorë të republikës së Kanunit? Po ku jeni o Kryeministri më tolerant ndaj çështjes së gruas që u shqetësua shumë se vdiqën ca francezë, Presidenti që nuk la më lapanjozë pa u dhënë medalje por që nuk gjeti kohë për një mesazh për 8 Marsin, Kryeparlamentari i një parlamenti me kriminelë. Kryeopozitari i parkingjeve me para? Keni rënë në gjumin e vdekjes. Unë nuk pranoj!³⁸”.

“Ne themi çfare thote partia³⁹!”, “Opozita- martirë të ndershmërisë⁴⁰”.

Sinonim: Fjalë me kuptim të afërt, që shprehin për afërsisht të njëjtën ide: Ja mbathi dhe iku; “Ik dhe largohu”. Replika në Parlament: S. B.: “Kur do të qërohet K.K., ky mamuth E quaj ditë të mirë, e quaj ditë të bardhë”. J. T.: “S.T., ik, largohu!”.

Solecizëm: Përdorim i gabuar i fjalëve, i formave të fjalëve ose i ndërtimit të fjalisë: *Pej Laqi, me mue, pa mue, si keni kenë?*

Shkallëzim: Figurë stilistike që krijohet duke e paraqitur mendimin me fjalë të njëpasnjëshme, përherë e më të fuqishme, që vijnë duke ia shtuar forcën shprehjes: “*Shqipëria dhe modeli i qeverisjes “ha, merr, ik”* (postim në facebook). “*Kjo është e pahijshme, e keqe, e shëmtuar, madje, mund të them, skandaloze*”.

³⁷ I. Yzeiri, *Pas mbretit, vjen Veziri*, “Shqip”, Gusht, 2015.

³⁸ E. Kristo, në faqen “Facebook”, 2015.

³⁹ E. Rama, në faqen sociale “Facebook”.

⁴⁰ I. Yzeiri, shih 3.

Fjalë të huaja: Fjalë që përdoren nga folësi për qëllim të ndryshëm: për manerizëm, erudicion, karakterizëm etj.:

- **Turqizma:** fjalët me prejardhje nga turqishtja: këta *bylykbashët* demokratikas, këta *sharlatanë e agallarë, kollajllëku i pashallarëve* të rinj; Këta janë *bajraktarë!* E dinë Shqipërinë si *Çifligun e tyre!*; “Kryetaret e bashkise - pronarë *vilajetesh*⁴¹”

- **Italianizma:** fjalë dhe shprehje të gjuhës italiane: këta *pepinot (italianët)* po shtohen çdo ditë këtu, *velinat* e televizionit, *primadona* e parlamentit etj.

Argotizëm: Një formë karakteristike për një grup shoqëror, që nuk kuptohet nga të tjerët. Argotizmat përdoren shumë sidomos në rrejet sociale dhe marrin formën e shkurtesave si në rastet: *klm* (kalofsh mirë), *tksh* (të kam shpirt), *klb* (kalofsh bukur), *xoxo* (puthje dhe përqaftime), *lol* (me shumë dashuri) etj.

Metonimi: Ndryshimi i emrave të objekteve, ideve e dukurive, duke i quajtur me emra të tjerë: Në Ersekë ndjekësit e një feje të krishterë quhen nga banorët “*alelujat*” etj.

Neologjizma: Fjalë të formuara nga subjekti ose të tjerët, të pafutura në Fjalorin e Gjuhës si: *kriptokomunist, bllokmen, bashkëvuajtës, murthyes (P. Zogaj), keqeverisje, dorëheqës, dorëhequr, politikëbërje, politikëbërës, shtetbërje, shtetkapje, krenarist*⁴², *kanabist*⁴³, *pornopolitikë*⁴⁴.

Aksimoroni: Figurë me fjalë me kuptime të kundërta, që duket sikur kundërshtojnë njëra tjetrën, por në fakt i japin shprehjes gjallëri dhe efekt të posaçëm: “Ky ishte një *gëzim i hidhur*”, “ishte një *fitore e humbur*⁴⁵”, “ishte një *humbje dinjitoze*⁴⁶”, “m’u drejtua me një *butësi lutese*⁴⁷”, “ky është një *dëshitim i suksesshëm*⁴⁸”.

Panegjrik: Ligjëratë solemne e mbajtur në rast ngjarjesh të rëndësishme. Ligjëratë e mbushur me lëvdata të tepruara që i thuhet një personi, një veprë. “*Sot edhe natyra po qan*” (R. Alia, në varrimin e Enver Hoxhës).

Frazeologjizmat si njësi ligjërimore mendësore

Njësitë frazeologjike nga vetë funksioni i tyre në komunikim kanë ngjyrim emocional mendësor. Kuptimi i njësisë frazeologjike nuk krijohet nga shumatorja e elementeve përbërës, por nga kuptimi i spikatur formuar nga shndërrimet konotative mendësore që ka marrë njësia si e tërë gjatë një procesi të caktuar. Për këtë arsye ato e bëjnë komunikimin ndërpersonal, por sidomos atë politik më të

⁴¹ I. Yzeiri, shih 3.

⁴² Gazeta “*Tema*” dt 21 Prill, 2015, F. Lubonja replikon me B. Blushin mbi “Vdekjen e Rilindjes”.

⁴³ Gazeta “*Tema*” dt 21 Prill, 2015, shih 35.

⁴⁴ S. Berisha, faqja sociale “*Facebook*”, Maj, 2015.

⁴⁵ E. Rama, shih 21.

⁴⁶ E. Rama, shih 21.

⁴⁷ E. Rama, shih 21.

⁴⁸ E. Rama, shih 21.

Shprehja e mendësive përmes figurave retoriko-stilistikore...

veçantë, duke theksuar sidomos forcën shprehëse dhe ndikuese (perlokutive⁴⁹) tek dëgjuesit dhe në të njëjtën kohë e bëjnë dhënësin e mesazhit më interesant dhe më karizmatik në sytë e dëgjuesit. Togfjalëshat frazeologjikë kanë karakter të qëndrueshëm, sepse lidhja e elementeve përbërëse të togfjalëshit është shumë e fortë, e fiksuar dhe e ngurtësuar dhe për këtë arsye ato kanë një përdorim shumë të gjerë në komunikimin mendësior. Përdorimi i frazeologjizmave dhe fjalëve të urta mund të konsiderohet kryesisht si veçori e gjuhës së periudhës së pluralizmit, ku komunikimi, sidomos ai politik, nuk është i klishezuar dhe i ngurtësuar siç ishte në kohën e monizmit.

Në kontekstin e këtij punimi shprehjet frazeologjike dhe fjalët e urta që pasqyrojnë mendësi, mund të ndahen në dy grupe të mëdha:

1. Të drejtpërdrejta, pa modifikim të elementeve përbërëse, ashtu siç përdoren si të tilla, me kuptimet përkatëse, si: “*I shtrenjtë në krunde dhe lirë në miell*”, “*I këndojnë dyzet gjela mbi kokë*”, “*Njëri ha kumbulla e tjetrit i mpihën dhëmbët*”. Ky lloj i shprehjeve frazeologjike është më i përdorur në krahasim me shprehjet frazeologjike të modifikuara. Përdorimi nga liderët politikë i shprehjeve frazeologjike të pamodifikuara bëhet për të ngushtuar largësinë midis liderit dhe pasuesve politikë, si edhe për të theksuar natyrën e popullore të liderave. Kjo gjë shton mundësinë e shtimit të pasuesve dhe të ndikimit të tyre për të vepruar në mënyra të ndryshme rreth një kauze të caktuar.

2. Të modifikuara, ku kemi ndërhyrje në elementet përbërëse në përshtatje me situatën, në të cilën përdoren. Kështu, p.sh., “*Flet si e ëma e Zeqos në majë të thanës*” modifikohet në shprehjen e mendësiuar “*Flet si dhëndrri në majë të kullës Eifel*”. Në këtë rast analogjia me thënien origjinale është e dukshme, edhe pse në vend të “nënës” kemi “dhëndërr”, ku në fakt flitet për një lider politik, dhe në vend të “thanës” kemi *kullën Eifel*. Situata ligjërimore zhvillohet në Francë, ku përdodh një ngjarje politike. Në këtë kontekst procesi i mendësimit realizohet, duke u bazuar në kompetencën njohëse, si të folësit, ashtu edhe të dëgjuesit (të dy duhet të kenë njohuri në lidhje me shprehjen popullore dhe në të njëjtën kohë të kenë njohuri në lidhje me ngjarjen politike që ndodh në Francë dhe individët që marrin pjesë aktive në atë ngjarje politike).

Po kështu shprehja frazeologjike “*Stambolli digjet e K. krihet*” modifikohet në “*Gerdeci digjet, kryeministri krihet*”, e cila mund të interpretohet në mënyrë të përshtatshme, sipas analogjisë së të dy shprehjeve. Përdorimi i shprehjeve frazeologjike apo shprehjeve të urta popullore të modifikuara në komunikimin politik e shton edhe më tepër perlokutivitetin e thënieve dhe forcën e tyre shprehëse. Shprehjet frazeologjike të modifikuara nëpërmjet ndërhyrjes në strukturë dhe në përbërje bëjnë që niveli i mendësimit të tyre të jetë shumë i lartë. Përdorimi i tyre ka për qëllim të diskretitojë kundërshtarin, të theksojë anë të caktuara të tij, si injorancën, budallallëkun apo dhe paaftësinë politike dhe abuzimi me interesat publike si, p.sh.: *Urtë e butë e plot tigani* → *Urtë e butë plot*

⁴⁹ Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës, prej Antikititit deri në kohën e sotme*, “Arbëria”, 2010.

Halimi (për babaxhanllëkun e kandidatit për kryebashkiak të Tiranës Halim Kosova në fushatën parazgjedhore). Në të njëjtën kohë këto shprehje të modifikuara bëhen edhe përfaqësuese të periudhave të caktuara të historisë së vendit: dihet se kur ka ndodhur shpërthimi i Gërdecit dhe se cila forcë politike u përfol në atë kohë si përgjegjës për shpërthimin dhe humbjen e jetës së njerëzve të përfshirë.

“Fjalitë e frazeologjizuara⁵⁰” janë po ashtu dukuri interesante me forcë shumë të madhe shprehëse për t’u trajtuar nga këndvështrimi mendësior. Fjalitë e frazeologjizuara, të tilla si: “*ta lidh kalin tek gjuha ime*” në kuptimin që “thashë diçka që s’duhet ta kisha thënë”, apo “tregova një informacion që s’duhet ta kisha thënë”, përdoret për një situatë adekuate politike.

Gjymtyra “*vatër*”⁵¹ e njësive frazeologjike quhet fjala që mban peshën kryesore, sidomos të vlerave të konotuara mendësioze të njësisë frazeologjike. Shembuj të njësive *vatër* përbëjnë rastet, si:

1. Gjymtyrë “*vatër*” përdoren fjalët në përputhje me ngjyresën kuptimore që kërkon t’i japë njësisë subjekti folës sipas situatës politike përkatëse. Kështu, p.sh., gjymtyrët *vatër baba, bijë, njerë, nënë* përdoren për të shprehur qëndrim ndaj pabarazisë në trajtimin e të tjerëve, mosbesim, vazhdimësi negative, ligësi si në shprehjet frazeologjike: *ca të babait, ca të njerkut; i tregon babait arat; bëmë baba të të ngjaj, i bërtet të bijes të dëgjojë e reja, s’ka bir nënë ta bëjë etj.*

2. Në shumicën e rasteve si gjymtyrë *vatër* përdoren pjesët e trupit të njeriut: “*turinj*”, “*ballë*”, “*syri*”, “*bark*”, “*gojë*”, “*shalë*”, “*dorë*”, “*kokë*”, “*këmbë*”, “*gjuhë*”, “*hundë*”, “*kocka*”, “*krahë*”, “*kraharor*”, “*dhëmbë*”, “*lëkurë*”, “*sqetull*” që shprehin qëndrime negative dhe tallje për sjellje të tilla si gënjeshtria, paturpsia, budallalliku, frika, llafazanllëku, pabesia, mashtrimi, presioni, varfëria nëpërmjet shprehjeve frazeologjike: *e ka të shkruar në ballë; s’i nxihet balli; i hap barkun; i ka trutë në bark; për një bark bukë, me bisht ndër shalë, i a mbylli gojën, me plot gojën, e ndyu gojën, e ka shthurur gojën, e zbertheu gojën, i erdhi goja, hedh gurin e fsheh dorën, e ka në gjak, me gjak të ftohtë, iu ndez gjaku, i këndojnë dyzet gjela mbi kokë, nuk i hyn gjëmb në këmbë, nuk i rri gjuha në në vend, e tërheq për gjuhë, e ka zbertheu gjuhën, e tërheq për hundë, fut hundet, e ka ngritur hundën përtpjetë, ia nxorri nga hundët, përpara hundës, ditën të lëpin këmbët e natën të ngul dhëmbët, ia vuri këmbët në një këpucë, derisa të bien kockat, ka shkuar thika në kockë, kockë e fortë, la kockat rrugëve, një kokë kanë, ia kaputi kokën, kokë turku, e pagoi me kokë, ia shplau kokën, shpëtoi kokën, të thyen kokën, më preu krahët, prapa krahëve, rreth kraharorin, njëri ha kumbulla e tjetrit i mbihën dhëmbët, i kanë zënë sytë lesh, i është trashur lëkura, t’a sjell shpirtin në majë të hundës, e mat detin me pëllëmbë, etj.*

3. Si gjymtyrë *vatër* përdoren emërtimet e kafshëve / shpendëve / insekteve: “*gomar*”, “*derr*”, “*ka / qetë*”, “*kalë*”, “*gjel*”, “*pulë*”, “*lepur*”, “*dele*”, “*lope*”, “*merimangë*”, “*morr*”, “*ujk*” për shprehjen e kuptimeve të tilla si: budallallëk,

⁵⁰ J. Thomai, *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*, Shkenca/13.

⁵¹ J. Thomai, shih 50.

Shprehja e mendësive përmes figurave retoriko-stilistikore...

naivitet, mungesë e intuitës, mungesë e planifikimit, mungesë e iniciativës, frikë, ndërhyrje e padrejtë në çështje që nuk duhet, zili, cmirë, poshtërsi, nënshtrim, përfitim i padrejtë, shfrytëzim i padrejtë i situatës / pushtetit: *i duket prifti gomar, nuk e nxjerr gomarin nga balta, prit gomar të mbijë bar, kur të pjellë gjeli, humbi qetë e pyet për brirët, e majm kaun ditën që do ta therë, i pjell edhe kau edhe mushka, ka rënë shumë herë nga kali, s'ia kam hipur atij kali, kalë i ngordhur, doli kërraçi para gomarit, i erdhi lepuri në shteg, i ka futur lepurin në bark,*

4. Si gjymtyrë “vatër” përdorën gjësede (mjete/ushqime): “gotë”, “kusi”, “lugë”, “miell”, “bukë”, “shoshë”, “kandar”, “kandil”, për të shprehur qëndrim negativ për disa cilësi të personalitetit të subjektit të tilla si: paaftësia, mosmirënjohja, inferioriteti, entuziazmi i tepruar, besimi i tepruar, vendosja e gabuar e prioriteteve, gënjeshtra, vëmendje e tepruar si: *mbytet në një gotë ujë, i bie bukës me këmbë, kusia në prush e thëllëza në fushë, do të hamë me lugë të florinjët, është lugë për vegsh, të ngop me lugë të zbrazët, e than detin me lugë, i lirë në miell e i shtrenjtë në krunde, mbulon diellin me shoshë, me kandar e farmacistit, nuk ngre kandar, s'ia kam mbajtur kandilin;*

5. Si gjymtyrë vatër përdorën fjalët që shënojnë fruta/perime: “kungull”, “kumbull”, “lakër”, “mollë”, për të theksuar anë negative të situatës apo subjektit të tilla si: gënjeshtra, shfrytëzimi i situatës, zbulimi i së vërtetës: *u bë kungulli e mori gardhin, mban dy kunguj nën një sqetull, ka lakra në kokë, i dolën lakrat në shesh, i bie shiu në lakra, u bë mollë sherri.*

6. Si gjymtyrë vatër përdorën fjalët që shënojnë ngjyrat: “e bardhë”, “e zezë”, për të theksuar tipare të personalitetit si: ngushtësia në perceptim, aktualizimi i situatës, shpirtgjerësia në trajtimin e një çështje: *e ka zemrën e bardhë; e bën të zezën të bardhë; i sheh gjërat bardh e zi.*

7. Si gjymtyrë vatër përdorën fjalët që shënojnë institucione: “kishë”, “kështjellë” për të shprehur qëndrim kryesisht negativ ndaj një situatë apo individi të caktuar: *kështjellë në rërë, gjete kishë ku të falesh.*

Disa shembuj të frazeologjizimeve të mendësiuara, të përdorura me kuptime tipike për situatë specifike politike: *Më erdhi lepuri në shteg:* më erdhi rasti i volitshëm për të goditur dikë a për të bërë diçka, m'u krijua mundësia më e mirë, u krijuan rrethana të përshtatshme: *Opozitës i erdhi vetë lepuri në shteg këtë herë; I sheh gjërat bardh e zi:* i sheh gjërat në mënyrë të thjeshtëzuar, vetëm mirë apo vetëm keq; është gjithnjë i skajshëm në gjykime. Një politikan për një politikan nga partia opozitare: - “ky tërë jetën e ka parë politikën shqiptare *bardh e zi*”. U bë lepur: u tremb shumë. Një qytetar për komshiun që bën biznes të paligjshëm: - “*U bë lepur, kur pa ata të zyrës së taksave*”. *Një i bie gozhdës, tjetri patkoit:* s'merren vesh midis tyre: Thuhet shpesh për parlamentarët kur do të miratojnë ndonjë ligj apo bëjnë ndonjë debat. Një qytetar për parlamentarët që po miratojnë një ligj: - Presim ne nga këta ligje të mira! Posi! Në Parlamentin tonë *një i bie gozhdës, tjetri patkoit; I dalë boje nga i ka dalë boja:* ka imazh të keq. Një qytetar për një politikane: - “*Kjo është grua e dalë boje*”. *Pa lënë gjurmë:* kur nuk ka rezultat puna apo veprimtaria: një qytetar për një parti që ka qenë në pushtet, por ka humbur në zgjedhje: *këta drejtuan pa lënë asnjë gjurmë; Është i lirë në miell e i*

shtrenjtë në krunde, ruan me trastë e prish me thasë: këta qeveritarët nuk luftojnë korrupsionin e madh dhe vjedhjet, por luftojnë plakat e shkreta që shesin qepet e domatet e bahçes, dihet janë **të lirë në miell e të shtrenjtë në krunde**; *Mban dy kunguj nën një sqetull*: merr përsipër të bëjë dy punë të rëndësishme në të njëjtën kohë. P.sh., kur E. Rama ishte edhe kryetar bashkie e kryetar i partisë socialiste, kundërshtarët e tij thoshin që ai **“po mban dy kunguj nën një sqetull”**. Po kështu flitet nga kundërshtarët për L. B.; *(Ra) si miu në çark (në poç), ra në grackë (sinonim)*: nuk ka më shpëtim, e pësoi keq e nuk shpëton dot): Një politikan thotë për një politikan tjetër pas një skandali: - **“Po ky ra si miu në çark”**. *Bluan miell të hollë, pret hollë (sinonim)*: thotë gjëra të mençura, është i mprehtë nga mendja: Një ndjekës, për liderin e partisë: - *“Ehu, është i mençur ai, e bluan miellin hollë dhe jo trashë si zot rrote (let, art)”*. *“Është i lirë në miell e i shtrenjtë në krunde”*: harxhon pa kursim diçka të vlefshme e kursen diçka tjetër më pak të vlefshme. Bën lëshime për gjëra të çmuara dhe e nuk lëshon për gjëra të parëndësishme. “Ky nuk është politikan i zoti, sepse me politikën e re të taksave ka treguar se është i lirë në miell e i shtrenjtë në krunde”.

Siç mund të vërehet, nga sa parashtroam më sipër, trajtimi i pasqyrimin të figurave retorike-stilistikore dhe i frazeologjizmave në njësitë mendësore, sidomos të atyre me karakter politik, mund t'i nënshtrohet në të ardhmen analizave më të thella e më të gjëra për të nxjerrë në pah shprehjen prej tyre të mendësive në fushën e politikës në shoqërinë pluraliste, ku përdorimi i tyre për shkak të lirisë së gjerë të fjalës është më i madh dhe më i gjerë.

BIBLIOGRAFI

a) Vepra:

- B. Londo, *Ti je zemra, Parti*.
 E. Hoxha, *Hrushovianët: Kujtime*, Tiranë, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1980.
 E. Rama, *Kurban*, Botimet “Dudaj”, Tiranë, 2011.
 F. Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, “Infbotues”, Tiranë, 2013.
 J. Thomai, *Aspekte shoqërore –kulturore në formimin e frazeologjizmave të shqipes*, SF, 1975.
 J. Thomai, *Fjalor Frazeologjik i Gjuhës Shqipe*, “Shkenca”, 1999.
 J. Thomai, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, SF, 1964.
 P. Zogaj, *Fillimet* (Ngjarje, dëshmi, kronikë, refleksione nga vitet '90-'92), Tiranë, 2014.
 Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës, prej Antikitetit deri në kohën e sotme*, “Arbëria”, 2010.

b) Artikuj:

- A. Bushati, *Ata që Prifti nxorri lakuriq*, “Lapsi al”, Tiranë, 1-10-2015.
 A. Bushati, *Ndeshja: Pse kaq frikë kundër Serbisë?*, Shtator, 2015.
 A. Bushati, *Një përgjigje për Ramën: Ne do vazhdojmë me Laps në dorë*, “Lapsi al”, Tiranë, Tetor, 2015.
 A. Bushati, *Rreziku i një opozite qesharake*, “Lapsi al”, Tiranë, Shtator, 2015.
 F. Lubonja, *Rama peng apo pjesë e krimit?*, “Panorama”, Shtator, 2015.
 F. Lubonja, *Vdekja e Rilindjes* (replikë me B. Blushin), “Tema”, Prill, 2015.
 I. Yzeiri, *Në vend të hashashit, shkollën*, “Shqip”, Tiranë, 7-9-2015.
 I. Yzeiri, *Pas mbretit, vjen Veziri*, “Shqip”, Gusht, 2015.